



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT - VENDIM**

**MBI**

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET PNUD DHE BASHKISË BERAT  
NË KUADËR TË PROGRAMIT “RELOAD 3”**

**Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ .04.2026**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Integrimi Evropian dhe Projekteve, mbi “Miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat në kuadër të programit “RELOAD 3”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar , ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr. 43/2016 “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 775 datë 24.09.2010 “Për Administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë” pika 24, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për Regjistrimin, Përdorimin, Rakordimin, Raportimin dhe Publikimin e Fondeve të Financimeve të Huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Berat me nr.5675 Prot., datë 06.10.2025, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 78, date 20.10.2025 Mbi miratimin e projektit “Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (ReLOaD3)”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028”, si dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë marrëveshjen e financimit ndërmjet PNUD dhe Bashkisë Berat në kuadër të programit “RELOAD 3 (Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3)”, bashkëngjitur këtij projekt vendimi.
2. Bashkia Berat do të organizojë tri thirrje publike:

Thirrja Nr. 1, viti 2026, me vlerë totale te projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.

Thirrja Nr. 2, viti 2027, me vlerë totale te projekteve 4,500,000 leke, ku kontributi i bashkisë është 1,350,000 lekë dhe tarifa e menaxhimit (GMS 5%) është 67,500 lekë, duke e çuar kontributin total të bashkisë në 1,417,500 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Thirrja Nr. 3, për vitin 2028, me një vlerë totale prej 4,000,000 lekësh, e cila do të financohet plotësisht nga fondet e Bashkisë Berat

3. Fondi i nevojshëm prej 1,417,500 lekë për bashkëfinancimin e Bashkisë Berat për vitin 2026 do të përballohet nga buxheti i vitit 2026, Fond për Bashkëfinancime në projekte me financim të huaj në fushën e shërbimeve publike, si më poshtë :

**Shtesë :**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Podukti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lekë
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,417,500
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			787,500
2102001	05	AF102	V823AAB	604	Transferte tek PNUD per bashkefinancim te projektit "Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (RELOAD3)"	787,500
		AD102	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve			630,000
2102001	05	AD102	V422AAC	604	Transferte tek PNUD per bashkefinancim te projektit "Programi Rajonal per Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor 3 (RELOAD3)"	630,000
<b>Total Shtesa</b>						<b>1,417,500</b> në lekë

**Pakësim :**

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Podukti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lekë
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				1,417,500
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			1,417,500
2102001	05	AB102	P626ACT	231	Fond per Bashkefinancime ne projekte me financim te huaj ne fushen e sherbimeve publike	1,417,500
<b>Total Pakësim</b>						<b>1,417,500</b>

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve si dhe Drejtoria Juridike.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETAR**  
**EVISA ÇELA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

**“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. LULJETA KAÇELI, BANESA E SË CILËS ËSHTË DËMTUAR NGA SHIRAT, NGA BUXHETI I VITIT 2026 NË MINISTRINË E MBROJTJES, PROGRAMI “EMERGJENCAT CIVILE”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile” i ndryshuar dhe VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare për shtetasen znj.Luljeta Kaçeli për dëmtimin e banesës nga shirat e rënë në datën 18.02.2026.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. Të akordojë si ndihmë emergjente financiare, nga fondet e kushtëzuara të akorduara për mbrojtjen civile për vitin 2026 për Bashkinë Berat familjes së shtetasës znj. Luljeta Kaçeli, në vlerën: 159,739 (njëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) lekë.
4. Ndhima financiare për familjen e shtetasës znj. Luljeta Kaçeli përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
5. Ndhima financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasës znj. Luljeta Kaçeli banesa e të cilit është dëmtuar nga shirat e rënë.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Evisa Çela**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

Nr. \_\_\_\_ .Prot.

Berat, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

PROJEKT-VENDIM

NR \_\_\_\_\_ DATE \_\_\_\_\_ .2026

**Për Miratimin e Raportit të Performancës 2025**

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat Publike Vendore”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030”, parashikohet ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Matjes së Performancës (SMP), me qëllim rritjen e cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve publike në nivel vendor.

Në këtë kuadër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Berat miratimin e Raportit të Performancës për vitin 2025, i cili paraqet vlerësimin e treguesve kryesorë të shërbimeve vendore, ecurinë e performancës së bashkisë dhe rekomandimet për përmirësimin e tyre.

Raporti i Performancës për vitin 2025 përfshin vlerësimin e funksioneve dhe treguesve kryesorë në fushave:

- Arsimit parauniversitar
- Menaxhimit të mbetjeve
- Mbrojtjes nga zjarri
- Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
- Administrimit të pyjeve dhe kullotave
- Mbrojtjes sociale
- Qeverisjes së mirë
- Menaxhimit financiar

Bashkëngjitur gjeni relacionin shpjegues dhe kopje e Raportit të Performancës 2025.

Ju faleminderit,

Grupi i punës për matjen e performances:

**Kryetar Grupi** :Arisa Toska

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Koordinator**: Marius Qytyku

EVISA CELA

**Specialist**: Jorida Papa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT - VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, Datë / / 2026

**“MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.93, DATË 28.12.2021, TË KËSHILLIT BASHKIAK, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E BERATIT”, TË NDRYSHUAR”.**

Këshilli Bashkiak , në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /2026, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në zbatim të nenit 8, pika 2 e nenit 9, pika 1/1, shkronja b, nenit 9 pika 1/3, shkronja b, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave :

VENDOSI :

1. 1.Të miratojë ndryshimet si më poshtë:

Kreu I, Neni 40 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“III.Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II. “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“III.Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 41, pika 3

Ishte:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapsirave publike për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe

kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapsirave publike për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 41, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu II, Neni 44 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II, a.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“II, c. Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II, a “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“II, c “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 45, pika 3

Ishte:

Tarifa e ndriçimit publik për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e ndriçimit publik për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 45, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimn”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu III, Neni 48 ,Pika 2, kategoritë dhe nënkategoritë, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“III.Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“ II. “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“III.Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 49, pika 3

Ishte:

Tarifa gjelbërimit publik për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa e gjelbërimit publik për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 49, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimn”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “ Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Kreu IV, Neni 52 ,Pika 2, terminologjia për kategorizimin e biznesit në tabelë

Ishte:

“II, a.Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

“II, c. Subjekte të tatimit mbi fitimin”

Bëhet:

“II, a “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë”

“II, c Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”.

Neni 53, pika 3

Ishte:

Tarifa për infrastrukturen arsimore për kategorinë II “Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “Subjekte të tatimit mbi fitimin”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Bëhet:

Tarifa për infrastrukturen arsimore për kategorinë II “Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, paguhet për çdo adresë (kryesore dhe dytësore) ku subjekti zhvillon aktivitetin

Neni 53, pika 9

Ishte:

Për kategorinë II “ Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” dhe kategorinë III “ Subjekte të tatimit mbi fitimin”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

Bëhet:

“Për kategorinë II “ Biznese me xhiro vjetore 0 (zero) deri në 8 (tetë) milion lekë” dhe kategorinë III “Biznese me xhiro vjetore mbi 8 (tetë) milion lekë”, detyrimi paguhet me dy këste të barabartë,

- Kësti I parë, brenda datës 20 Prill
- Kësti I dytë, brenda datës 20 Korrik

2. Ndryshimet e miratuara në këtë vendim kanë efekt nga 1 Janar 2026.
3. Klasifikimi i bizneseve për efekt tarifimi vendor do të bazohet në xhiron e realizuar në vitin paraardhës, sipas të dhënave zyrtare të deklaruara nga subjekti në sistemin tatimor.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR  
I KËSHILLIT BASHKIAK  
Evisa Çela



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJËRAVE DHE  
SHËRBIMIT VETERINAR**

Nr \_\_\_prot

Berat ,më \_\_\_\_\_

**PROJEKT-VENDIM**

**“PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK**

Këshillit të Bashkisë Berat , sot më datë \_\_\_/\_\_\_2026, I paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi I Bashkisë Berat për miratimin e fondit për trajtimin e qenve endacake në qytetin e Beratit.

Bazuar në ligjin Nr 139 /2015 “Për qeverisjen vendore” kreu VII “Funksionet dhe kompetencat e Nësive të vetqeverisjes Vendore,,neni 27 “Funksionet e Bashkive në fushën e Bujqësië,,Zhvillimit Rural ,pyjeve, kullotave publike,natyrës dhe biodiversitetit” në ligjin e Shërbimit Veterinar në Republikën e Shqipërisë nr. 10465 datë 29.09.2011 neni 56, I ndryshuar me ligjin nr. 71 datë 04.06.2020 neni 21, pika 1, shkronja a ,shkronja ç si dhe V.K.M nr 475 datë 30.07.2021 për detyrat funksionale të Shërbimit Veterinar të Njësive të Qeverisjes Vendore kreu III, ”Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenëve dhe maceve endacake, ekzekutivi I Bashkisë BERAT

**VENDOSI**

- 1.Miratimin e fondit në shumën lekë 1 000 000(një milion) për trajtimin e qenve endacakë.
- 2.Për ndjekjen e procedurave të mëtejshme administrativo-ligjore, ngarkohet ekzekutivi I Bashkisë BERAT

**KRYETARE E KESHILLIT BASHKIAK**

**EVISA CELA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KESHILLI I BASHKISË BERAT**

**PROJEKT VENDIM**

Nr. . datë \_\_\_\_\_ 2026

**"PËR  
MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË  
GJINORE  
2026-2028"**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore",  
Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", i ndryshuar;  
Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar;  
Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021—2030;  
Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për integrimin e barazisë gjinore në politikat vendore;  
Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW); Kryetari i Bashkisë i paraqet Këshillit të Bashkisë Berat;

**VENDOSI**

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026-2028.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria Juridike , Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit urban, lejeve dhe monitorimit të investimeve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Drejtoria e Emergjencave, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtoria e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Arsimit, Drejtoria e Integritit Europian dhe Zhvillimit Strategjik, Drejtoria e Arsimit, Kultures dhe Rinisë, Agjensia e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Bujqësisë, Adiministrit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar.

**KRYETAR I I KËSHILLIT BASHKIAK**  
**EVISA ÇELA**